



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ENERGJISË  
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE ✓

Nr. 8126

Tirane, date 15.12.2015

Drejtuar: Z.ARTAN KUQO  
SHOQERIA "K - 12" SH.P.K  
BULEVARDI "RESHIT ÇOLLAKU", VILA 24,

POGRADEC

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV  
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE  
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR  
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE  
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1021 date 13.06.2007.

I nderuar z. Kuqo,

Shoqëria "K - 12" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1021 date 13.06.2007, për mineral hekur – nikel dhe nikel - hekur ne objektin "Xhumage – Liqeni i Kuq", Librazhd, ne Qarkun Elbasan.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr.8138 date 07.09.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.6025 date 08.09.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.1021 date 13.06.2007, për mineral hekur – nikel dhe nikel - hekur ne objektin "Xhumage – Liqeni i Kuq", Librazhd, ne Qarkun Elbasan, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2012 – 2013 dhe vitin 2015 - 2016.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hytjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në germën “ç” të pikës 1 të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa me sipër në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1021 datë 13.06.2007, për mineral hekur – nikel dhe nikel - hekur në objektin “Xhumage – Liqeni i Kuq”, Librazhd, në Qarkun Elbasan, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1021 datë 13.06.2007, për mineral hekur – nikel dhe nikel - hekur në objektin “Xhumage – Liqeni i Kuq”, Librazhd, në Qarkun Elbasan.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitetet minerare.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

**MINISTRI**

**DAMIAN GJIKNURI**

